

| INFORMATA PËR VIZITORËT

Higjiena në spital



Higjiena në spital

Mbrojtja e pacientëve tanë qëndron në radhë të parë. Me masat vijuese higjienike ne dëshirojmë ti mbrojmë pacientët nga infektuesit në spital. Na ndihmoni ti zbatojmë këto ashtu që Ju këto masa të rekomanduara higjienike i praktikoni vetë.

Duart



Duart janë bartësit kryesorë të shkaktarëve të sëmundjeve. Për këtë arsye pastroni duart mirë me ujë dhe sapun:

- para hyrjes në dhomën e pacientit
- pas ndërrimit të pelenave apo përcjelljes në tualet
- pas përdorimit të tualetit
- para përgatitjes së ushqimeve
- para ngrënjes
- kur duart Tuaja janë dukshëm të ndotura

Po që se paraqitet nevoja, që Ju duhet ti dezinfektoni duart, Ju do udhëzoheni nga personeli profesional në dezinfektim të duarve. Kjo është e nevojshme në situata vijuese:

- Fëmija Juaj do izolohet.
- Ju merrni përsipër detyra teknike kujdesi si ajo e ushqimit të fëmijës Tuaj me sondë.
- Ju pomponi qumësht gjiri në spital.

Rrethina personale e fëmijës dhe dhoma e spitalit



Krevati dhe dollapi i natës i takojnë rrethinës personale të pacientit dhe këto guxojnë të preken vetëm nga familjarët dhe personeli.



Me pastrimin e përditshëm të dhomës së pacientëve ne kujdesemi për një rrethinë të pastër. Për ta mundur këtë, Ju jeni të udhëzuar, që Ju të e palosni krevatin Tuaj dhe gjërat private ti skajoni.



Nëse ju shfrytëzoni tavolinën e ndërrimit të pelenave, atëherë pas shfrytëzimit fshijeni atë plotësisht me lecka dezinfektimi.

Shenjat e sëmundjeve tek vizitorët



Informoni personelin kujdestarë, kur Ju e ndjeni veten të sëmurë apo keni shenja infektimi. Ju do informoheni për masat shtesë higjienike për mbrojtje të fëmijës Tuaj dhe fëmijëve tjerë.



Vëllezërit dhe motrat e sëmurë dhe vizitorët e sëmurë qëndrojnë në shtëpi.

Ju faleminderit shumë për bashkëpunimin Tuaj!



UNIVERSITÄTS-
KINDERSPITAL
ZÜRICH

| *Das Spital der
Eleonorenstiftung*

Kinderspital Zürich - Eleonorenstiftung
Steinwiesstrasse 75
CH-8032 Zürich

www.kispi.uzh.ch
Telefon +41 44 266 71 11